



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700638/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda : *Rekomandohet që nga ana juaj të merren masave që ekspertët mjeko-ligjor Dr.F. S. dhe Dr.Shk.E. Sh., të marrin pjesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, me datë 25.05.2017, ora 12.00 si ekspert mjeko ligjor në çështjen gjyqësore të shtetasit I. A..*

Drejtuar : **Z.Bledar XHEMALI**
Drejtor i Institutit të Mjeksisë-Ligjore

TIRANË

I nderuar zoti Xhermali,

Në institucionin e Avokatit të Popullit, shtetasi E. A. nga qyteti i Gramshit ka paraqitur një ankesë për zvarritje gjykimin pa shkaqe ligjore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, gjatë gjykimit të një kërkesë penale për lirim nga burgu për shkak të gjendjes shëndetësore të vëllait tij **I. A.**, i cili aktualisht ndodhet duke vuajtur dënimin me burgim të përjetshëm dhënë nga Gjykata Greke dhe të njohura nga gjykata shqiptare në I.E.V.P. Zahari Krujë.

Nga verifikimi ynë rezulton se kërkesa nga i dënuari I. A. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, është dorëzuar me datën 24.01.2017, dhe deri tani nuk është përfunduar akoma gjykimi i kësaj çështje gjyqësore dhe duke analizuar shkaqet e shtyrjes së gjykimit midis tyre del se ka qënë edhe mosparaqitja e ekspertëve mjeko ligjor Dr.F. S., dhe Dr.Shk.E. SH. në gjykim.

Kërkesa e kërkesit I. A. dhe e avokatit privat, Z.L.Th. para Gjykatës ishte se paraqitja në gjykim e ekspertëve mjeko ligjor është e domosdoshme për të sqaruar disa rrethana mbi gjendjen e rëndë shëndetësore të klientit të tij.

Duke u bazuar në kërkesat e nenit 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 6 /1 të KEDNJ ku përcaktohet se :

"Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjor, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe të paanshme e caktuar me ligj.

Po kështu në nenin 663/3 të kësaj Kushtetute, përcaktohet qartë dhe preër se:"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të Njeriut, nga administrata publike".

Në rastin konkret i dënuari I. A., i cili rezulton i dënuar nga Gjykata Greke me burgim të përjetshëm për vepra të ndryshme penale, se ai, ka deri tani ka vuajtur mbi 25 vjet burg, dhe tani gjatë vuajtjes së dënimit vuan përsëri nga sëmundje e rëndë shëndetësore dhe mendore, se ai gjatë vuajtjes së dënimit në burg në I.E.V.P.Krujë është

djegur me furnellë gazi dhe ka pësuar dëmtime të ndryshme në fytyrë duar dhe trup, kemi mendimin se mosparaqitja e ekspertëve tuaj në gjykim përbën shkelje të të drejtave të Njeriut, në gjykim dhe cënon procesin e rregullt ligjor.

Në këto kushte dhe duke u bazuar në kërkesat e nenit 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, ku përcaktohet se:”Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit, paraqet rekomandim për vënien në vend të së drejtës së shkelur nga organi administrativ, që sipas tij, ka shkaktuar shkeljen e të drejtave dhe lirive, Ju

REKOMANDOJMË :

1.Marrjen e masave organizative që ekspertët mjeko-ligjor Dr.F. S. dhe Dr.Shk.E. Sh., të marrin pjesë në seancën gjyqësore dt.25.05.2017 ora 12 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

2.Mbi masat e marra nga ana juaj, për zbatimin e këtij rekomandimi, lutemi të njoftohemi nga ana juaj me shkrim brenda 30 ditëve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI